

RAJONI, BASHKË PËR ENERGJI EFICIENTE



Eficienca e energjisë po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e vendeve të rajonit, në të njëjtën linjë me atë që po ndodh në Bashkimin European. Vendet e rajonit po shqyrtojnë modelet që do të ndihmonin në këtë drejtim. Shqipëria mbetet prapa, teksa pritet që legjislativi i ri të miratojë ligjin për eficiencën e energjisë...

Eficienca e energjisë po kthehet në një prioritet për të gjithë rajonin e Europës Juglindore. Në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare të Energjisë, të zhvilluar pak ditë më parë në Zagreb të Kroacisë, të organizuar në kuadër të Nismës për Dialogun Publik për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë në Europën Juglindore, përfaqësuesit e të gjitha vendeve u mbledhën për të shkëmbyer njohuritë dhe eksperiencën në planifikimin dhe zbatimin e veprimeve për një energji të qëndrueshme.

Ballafaqimi vjen pas konferencës së parë, të zhvilluar në Beograd të Serbisë, rreth një vit e gjysmë më parë. Roli i Parlamentit dhe qeverive lokale në promovimin e energjisë së qëndrueshme dhe mënyra se si shoqëria civile mund të kontribuojë në këtë zhvillim të qëndrueshëm, ishin në fokus të konferencës së dytë, ku rritja e ndërgjegjësimit nga të gjitha palët ishte e dukshme. “Deri tani eficienca e energjisë është neglizhuar nga vendet e Europës Juglindore”, tha

Maja Bozicevic, drejtoreshë e Qendrës për Zhvillim të Qëndrueshëm në Kroaci. “Ndaj ne synojmë të nxisim dialogun që do të identifikojë palët e interesuara për eficiencën e energjisë”.

“Çështja e eficiencës së energjisë po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e vendeve të rajonit, në të njëjtën linjë me atë që po ndodh në Bashkimin European dhe në Gjermani”, tha Brigitte Heuel-Rolf, drejtoreshë rajonale për Ballkanin Perëndimor e Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Gjermania, sipas saj, sot po shkon drejt energjisë së rinovueshme dhe eficiencës. Në lidhje me zgjidhjet për energjinë eficiente, ajo rekomandoi që duhen si

investime private dhe shtetërore, duke shtuar se janë 1 miliard euro të disponueshme për eficiencën e energjisë dhe projekte të lidhura me të.

“Sot gjendemi përballë dy mesazheve kontradiktore”, pohoi Janez Kopac, drejtor i Komunitetit të Energjisë, Kroaci. Nga njëra anë duhet më shumë energji për t’u zhvilluar dhe nga ana tjetër, më shumë eficiencë. Sipas tij, sot duhet ecur drejt zhvillimit të qëndrueshëm, që nënkupton edhe energji të qëndrueshme. “Eficienca e energjisë është një nga mënyrat me kosto më të ulët për të siguruar energji dhe mund të shihet si burimi më i madh i saj”. Për këtë arsye dhe Bashkimi European ka vendosur objektivin “20:20:20”

(përmirësimi 20% në efikasitetin e energjisë, 20% e konsumit të energjisë, e cila duhet të prodhohet nga burime të rinovueshme dhe 20% reduktim të ►►

Angazhimi

Shqipëria duhet të ulë me 9% konsumin e energjisë, përmes rritjes së eficiencës së energjisë në banesa, transport, shërbime e bujqësi deri në vitin 2018